
Varshavë, 1 korrik 2021

Mendimi-Nr.: GEND-MKD/413/2021 [JB]

MENDIM MBI PROPOZIM-LIGJIN PËR BARAZINË GJINORE

MAQEDONIA E VERIUT

Në këtë Mendim janë shfrytëzuar kontributet e përgatitura nga znj. Alice Thomas, eksperte ndërkombëtare ligjore dhe për të drejtat e njeriut, dhe znj. Dorota Ryza, eksperte për sundimin e ligjit dhe çështjet e barazisë gjinore

Bazuar në një përkthim zyrtar në anglisht të Propozim-ligjit të siguruar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Rr. Miodowa 10, PL-00-251 Varshavë
Telefoni në zyrë: +48 22 520 06 00, Faksi: +48 22 520 0605
www.legislationline.org

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIMET KRYESORE

Propozim-ligji për Barazinë Gjinore synon të integrojë më tej vetëdijen dhe aktivitetet për barazinë gjinore brenda shumicës së institucioneve publike, duke përfshirë edhe Kuvendin dhe pushtetin ekzekutiv, si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal. Një numër i organeve të barazisë gjinore të themeluara nga Ligji aktual për Mundësi të Barabarta janë ruajtur, edhe atë Komisioni për Barazi Gjinore në kuadër të Kuvendit dhe koordinatorët/këshilltarët për çështje gjinore brenda ministrive, organeve të tjera të administratës publike dhe organeve të vetëqeverisjes lokale. Në të njëjtën kohë, Propozim-ligji parashikon disa organe të reja të cilat, nëse krijohen si duhet dhe me burimet dhe trajnimet e nevojshme, duhet të ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të aktiviteteve të barazisë gjinore në sferën publike dhe private.

Më e rëndësishmja, Propozim-ligji parashikon një Sekretariat të ri për Barazinë Gjinore të themeluar nga Qeveria, i cili do të merrte përsipër rolin e koordinimit dhe të mbikëqyrjes së zbatimit të Propozim-ligjit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, e cila e ka këtë rol në bazë të Ligjit aktual. Megjithëse në parim ky është një hap i mirëpritur, dispozitat përkatëse të Propozim-ligjit duhet ta qartësojnë më tej rolin dhe kompetencat e këtij Sekretariati, në veçanti në lidhje me organet e tjera të krijuara rishtazi siç janë Qendra Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor dhe Organi Kombëtar Koordinues për Barazinë Gjinore. Qartësimi i mëtejshëm i disa termeve të përdorura, si dhe i diapazonit të Propozim-ligjit dhe i kompetencave të organeve ekzistuese të barazisë gjinore do të siguronin një qartësi më të madhe ligjore.

Më konkretisht, dhe si plotësim i asaj që u tha më lart, OSBE/ODIHR-i jep rekomandimet e mëposhtme për të rritur më tej efektivitetin e Propozim-ligjit:

- A. të sqarohet diapazoni i Propozim-ligjit në kuadër të neneve 1 dhe 2, veçanërisht termi "të gjitha sferat e jetës shoqërore"; [paragrafi 21] më tej, të rishikohet, të sqarohet dhe të përmirësohet përkufizimi i termit "diskriminim" në kuadër të nenit 4 të Propozim-ligjit; [paragrafët 22-24]
- B. në lidhje me masat për barazinë gjinore:
 1. të konsiderohet mundësia për të përcaktuar në Propozim-ligj afatin brenda të cilit duhet të miratohet rregullorja sipas nenit 7, paragrafi 2 (dhe rregulloret e tjera); [paragrafi 25]
 2. të konsiderohet mundësia për rishikimin e nenit 9 mbi masat e përkohshme, duke e zgjeruar zbatimin e tyre jo vetëm për të rritur barazinë midis burrave dhe grave, por edhe për të mbuluar diskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore; [paragrafi 26]
 3. të futet një mekanizëm monitorimi për masat e përhershme dhe të përkohshme për të vlerësuar nëse ato funksionojnë në praktikë; [paragrafi 27]
- C. të plotësohen nenet 13 dhe 14 në lidhje me Komisionin për Barazi Gjinore të Kuvendit, duke e sqaruar kuptimin e parimit të pjesëmarrjes së ekuilibruar, që

- do të merret parasysh për sa i përket përbërjes së organeve parlamentare të punës në bazë të nenit 13, paragrafi 4, duke e rishikuar dhe përmirësuar listën e kompetencave të Komisionit sipas nenit 14, paragrafi 2; [paragrafët 34-36]
- D. për sa i përket organeve të krijuara rishtazi për barazinë gjinore brenda pushtetit ekzekutiv:
1. të sqarohet se ku do të vendoset Sekretariati, i krijuar sipas nenit 24, dhe të sigurohen mjete financiare dhe trajnime të mjaftueshme për të siguruar se ai është në gjendje t'i përmbushë siç duhet detyrat e tij; [paragrafët 39-40]
 2. të rishikohet roli i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në lidhje me raportimin në nenin 16, paragrafi 4 dhe nenin 19, paragrafi 10; [paragrafi 41]
 3. të përcaktohet qartë roli dhe kompetencat e Qendrës Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në nenin 25 dhe të sqarohet se ku do të vendoset ajo brenda administratës shtetërore dhe si do të bashkëpunojë me Sekretariatit dhe organet e tjera publike; duhet të sigurohen burime të mjaftueshme për të siguruar efektivitetin e këtij organi; [paragrafët 42-43]
 4. të përshkruhen detyrat dhe kompetencat e Organit Kombëtar Koordinues në nenin 26, të specifikohet se si ndryshojnë ato nga detyrat dhe kompetencat e Sekretariatit dhe të sqarohet se si do të bashkëpunojnë këto dy organe; [paragrafët 46-47]
- E. të shtohen referime për komisionet lokale të barazisë gjinore në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, të sqarohet pjesëmarrja në komisionet e tilla sipas nenit 20, paragrafi 2, dhe të parashikohen sesione të rregullta trajnimi për burrat dhe gratë që janë anëtarë/e të komisioneve për barazi gjinore; [paragrafi 49]
- F. të specifikohen rolet e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNj) si mekanizma për shqyrtimin e ankesave në fushën e diskriminimit në bazë të gjinisë, seksit ose identitetit gjinor në Propozim-ligj, ose të përfshihen referime në ligjet përkatëse, të sigurohet se janë siguruar burime dhe trajnime të mjaftueshme për IKDNj-të dhe të përmirësohen nenet 14, 16 dhe 19 të Propozim-ligjit duke përfshirë edhe referimin për bashkëpunimin me IKDNj-të për organet përkatëse të barazisë gjinore; dispozita të ngjashme duhet të futen për organet e krijuara rishtazi nga Propozim-ligji; po ashtu, të rishikohen nenet 22 dhe 23 për të siguruar që monitorimi i mediave dhe detyrimet e vendosura për partitë politike janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; [paragrafët 52-58]
- G. të rivendosen të gjitha mekanizmat e mundshëm për mjetet ligjore dhe ankesat në Propozim-ligj, duke përfshirë referimet në mekanizmat e shqyrtimit të ankesave para IKDNJ-ve, të vlerësohet dhe të konsiderohet rivendosja e një mekanizmi administrativ për ankesa sipas këtij Propozim-ligji, ose të përfshihen referime në ligjet përkatëse. të shtohen masa mbrojtëse në procedurat gjyqësore dhe referime në elementet shtesë të përdorura në paditë gjyqësore sipas Ligjit Kundër Diskriminimit, të tilla si padi *actio popularis* (padi

për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik) dhe pjesëmarrje të palëve të treta, dhe të parashikohet ndihmë juridike për procedurat e tilla, sipas nevojës; dhe të rishikohen dhe të ofrohen detaje të mëtejshme mbi sanksionet siç janë llojet e ndryshme të gjobave në Propozim-ligj ose të ketë referime në rregullat specifike për kundërvajtje që zbatohen në raste të tilla; [paragrafët 59-64] dhe

H. të sigurohen konsultime publike adekuate dhe në përmasa të gjera gjatë hapave të ardhshëm të procesit të hartimit të ligjeve dhe të rishikimit të Propozim-ligjit dhe të sigurohet që në tërë tekstin është përdorur terminologji neutrale gjinore. [paragrafët 66-69]

Këto rekomandime dhe rekomandime shtesë janë përfshirë në tërë tekstin e këtij Mendimi, të theksuara me shkronja të trasha (zeza).

Si pjesë e mandatit të saj për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në zbatimin e përkushtimeve të OSBE-së, OSBE/ODIHR-i rishikon, me kërkesë të vendit, versionet draft të legjislacionit dhe legjislacionin ekzistues për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me përkushtimet e OSBE-së dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësim.

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	6
II. DIAPAZONI I MENDIMIT	6
I. ANALIZA LIGJORE DHE REKOMANDIMET	7
1. Standardet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përkushtimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së mbi barazinë gjinore	7
2. Sfondi	9
3. Dispozitat e përgjithshme të Propozim-ligjit	11
4. Masat për barazinë gjinore.....	12
5. Subjektet dhe mekanizmat përgjegjës për zbatimin e masave të barazisë gjinore 13	
5.1. Komisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore.....	13
5.2. Organet e Barazisë Gjinore në kuadër të pushtetit ekzekutiv	14
5.3 Organet e barazisë gjinore në nivelin lokal.....	17
5.4 Subjektet e tjera që e zbatojnë ligjin	17
6. Mjetet juridike dhe sanksionet.....	19
7. Rekomandime në lidhje me procesin e përgatitjes dhe miratimit të Propozim-ligjit 21	
7.1. Vlerësimi i ndikimit dhe qasja pjesëmarrëse	21
7.2. Hartimi i ligjeve neutrale ndaj gjinisë	22

SHTOJCË: Propozim-ligji për Barazinë Gjinore i Maqedonisë së Veriut

I. HYRJE

1. Më 15 mars 2021, Ministri i Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut i dërgoi Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme "OSBE/ODIHR") një kërkesë për rishikim ligjor të Propozim-ligjit për Barazinë Gjinore të Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme "Propozim-ligji"). Propozim-ligji synon të zëvendësojë Ligjin aktual për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat të vitit 2012 (në tekstin e mëtejme "Ligji për Mundësi të Barabarta").
2. Më 24 mars 2021, ODIHR-i iu përgjigj kësaj kërkesë, duke konfirmuar gatishmërinë e Zyrës për të përgatitur një mendim ligjor mbi pajtueshmërinë e Propozim-ligjit me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përkushtimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së.
3. Ky Mendim është përgatitur si përgjigje e kërkesës së mësipërme. OSBE/ODIHR-i e kreu këtë vlerësim brenda mandatit të tij siç përcaktohet nga Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore, i cili thotë se "[ODIHR-i], në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare dhe organet dhe institucionet përkatëse kombëtare, do t'u ndihmojë shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së të jenë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave, dhe në rishikimin e legjislacionit për të siguruar garanci të përshtatshme ligjore për promovimin e barazisë gjinore në përputhje me përkushtimet e OSBE-së dhe përkushtimet e tjera".¹
4. Në vitin 2011, OSBE/ODIHR-i rishikoi versionet e mëparshme të Ligjit për Mundësi të Barabarta të vitit 2006, dhe të Propozim-ligjit të vitit 2011 që synonte të ndryshojë atë ligj.²

II. DIAPAZONI I MENDIMIT

5. Diapazoni i këtij Mendimi e përfshin vetëm Propozim-ligjin e paraqitur për rishikim. Pasi është i kufizuar, ky Mendim nuk përbën një rishikim të plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjithë kornizës ligjore dhe institucionale që e rregullon barazinë gjinore në Maqedoninë e Veriut.
6. Mendimi ngre çështje kyçe dhe jep indikacione për fushat shqetësuese. Për të qenë sa më i thukët, ai përqendrohet më shumë në ato dispozita që kërkojnë ndryshime ose përmirësime sesa në aspektet pozitive të Propozim-ligjit. Analiza pasuese ligjore bazohet në standardet, normat dhe rekomandimet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, si dhe në përkushtimet përkatëse të dimensionit njerëzor të OSBE-së. Mendimi gjithashtu i thekson, sipas rastit, praktikat e mira nga shtetet e tjera pjesëmarrëse të OSBE-së në këtë fushë. Kur i referohet legjislacionit kombëtar, OSBE/ODIHR-i nuk avokon për modelin e ndonjë vendi konkret; ai më tepër përqendrohet në ofrimin e informacionit të qartë në lidhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke ilustruar se si ato zbatohen në praktikë në ligje të caktuara kombëtare. Shembulli i çdo vendi duhet të trajtohet gjithmonë me kujdes pasi që ai nuk

¹ Shih [Planin e Veprimit të OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore](#) miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror Nr. 14/04, MC.DEC/14/04 (2004).

² Shih Mendimin e OSBE/ODIHR-it mbi Ligjin për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të 9 qershorit të vitit 2011, dhe Mendimin e OSBE/ODIHR-it mbi Propozim-ligjin për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë të 16 shtatorit të vitit 2011.

mund të kopjohet (përsëritet) domosdoshmërisht në një vend tjetër dhe gjithmonë duhet të konsiderohet në dritën e kornizës më të gjerë institucionale dhe ligjore kombëtare, si dhe kontekstit të vendit dhe kulturës politike.

7. Për më tepër, në përputhje me *Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*³ (në tekstin e mëtejme "KEGjFDG") dhe *Planin e Veprimit të OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore të vitit 2004*⁴ dhe përkushtimet për përfshirjen e aspektit gjinor në aktivitetet, programet dhe projektet e OSBE-së, Mendimi integron, sipas nevojës, një perspektivë gjinore dhe të diversitetit.
8. Ky Mendim bazohet në një përkthim zyrtar në anglisht të Propozim-ligjit të siguruar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili i është bashkëngjitur këtij dokumenti si Shtojcë. Mund të ketë gabime si rezultat i përkthimit. Mendimi është gjithashtu në dispozicion në maqedonisht dhe në shqip. Megjithatë, versioni në anglisht mbetet versioni i vetëm zyrtar i Mendimit.
9. Duke marrë parasysh atë që u tha më sipër, OSBE/ODIHR-i dëshiron të theksojë se ky Mendim nuk e ndalon OSBE/ODIHR-in të formulojë rekomandime ose komente shtesë me shkrim ose me gojë mbi çështjet e shqyrtuara përkatëse në Maqedoninë e Veriut në të ardhmen.

I. ANALIZA LIGJORE DHE REKOMANDIMET

1. STANDARDET PÛRKATËSE NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PÛRKUSHTIMET E DIMENSIONIT NJERËZOR TË OSBE-SË MBI BARAZINË GJINORE

10. Standardet themelore ndërkombëtare të barazisë mund të gjenden në instrumentet gjenerike të të drejtave të njeriut siç është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejme "PNDCP").⁵ Neni 26 i PNDCP-së thotë se të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe se ligji do të ndalojë çdo diskriminim dhe do t'u garantojë të gjithë personave mbrojtje të barabartë dhe efektive nga diskriminimi në çfarëdo baze, duke përfshirë edhe për shkak të gjinisë së tyre. Ky parim gjendet edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (në tekstin e mëtejme "KEDNj"),⁶ kryesisht në nenin 14, i cili ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave të tjera të Konventës për shkak të, ndër të tjera, gjinisë së një personi, dhe Protokollin 12 të Konventës, i cili përmban një ndalim më të gjerë, të pavarur, të të gjitha formave të diskriminimit.
11. Një përkufizim i "diskriminimit ndaj grave" u miratua së pari në nenin 1 të KEGjFDG-së, i cili e përcakton këtë si çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë të gjinisë, që ka për efekt ose qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë të të drejtave të njeriut në fushën politike, ekonomike, kulturore, sociale, civile ose në fusha të tjera mbi bazë të barabartë me burrat. Shtetet palë në KEGjFDG duhet të punojnë

³ *Konventa e KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* (në tekstin e mëtejme "KEGjFDG"), miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 34/180 të datës 18 dhjetor 1979. Maqedonia e Veriut e trashëgoi këtë Konventë më 18 janar 1994.

⁴ Shih *Planin e Veprimit të OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore*, miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror Nr. 14/04, MC.DEC/14/04 (2004) paragrafi 27.

⁵ *Pakti Ndërkombëtar i KB-ve për të Drejtat Civile dhe Politike* (PNDCP), miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve 2200A (XXI) të 16 dhjetorit 1966. Republika e Maqedonisë së Veriut e trashëgoi PNDCP-në më 18 janar 1994.

⁶ *Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore* (KEDNj), nënshkruar më 4 nëntor 1950, ndërsa hyri në fuqi më 3 shtator 1953. Republika e Maqedonisë së Veriut e ratifikoi KEDNj-në më 10 prill 1997.

drejt eliminimit të diskriminimit të grave në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë, ndër të tjera, statusin ligjor, pjesëmarrjen politike, punësimin, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe strukturat familjare (neni 2).

12. Këshilli i Evropës ka lëshuar dokumente të shumta për tema që lidhen me barazinë gjinore, duke filluar me rezolutën 855 (1986) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejme "APKE") mbi barazinë midis burrave dhe grave,⁷ e cila u pasua nga rezoluta ose rekomandime të tjera që mbulojnë, ndër të tjera, barazinë e të drejtave midis burrave dhe grave,⁸ progresin në të drejtat e grave,⁹ situatën e grave në shoqërinë rurale¹⁰, pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike,¹¹ mekanizmat për të siguruar vendimmarrjen e grave,¹² përfaqësimin e grave në politikë përmes sistemit zgjedhor,¹³ masat për të luftuar diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor,¹⁴ mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara¹⁵ dhe barazinë gjinore dhe mediat.¹⁶ Rekomandimet më të fundit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës janë përqendruar në tema të tilla si integrimi i aspektit gjinor në sport, barazia gjinore në sektorin audio-vizual dhe parandalimi dhe luftimi i seksizmit.¹⁷
13. Përveç kësaj, si një vend kandidat për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian (në tekstin e mëtejme "BE"), Maqedonia e Veriut ka ndërmarrë dhe vazhdon të ndërmarrë hapa për ta harmonizuar legjislacionin e saj me legjislacionin (*acquis*) e BE-së. Në nivelin e Bashkimit Evropian, ekzistojnë dy direktiva kryesore (në tekstin e mëtejme "Direktivat Gjinore të BE-së") që i pasqyrojnë angazhimet e vendeve të BE-së për mbrojtjen e barazisë midis burrave dhe grave. Ato janë Direktiva e Këshillit 2004/113/EC mbi parimin e trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasjen në dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi zbatimin e parimit për mundësi të barabarta dhe trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit. Të dy Direktivat Gjinore të BE-së përfshijnë përkufizime të diskriminimit (të drejtpërdrejta dhe indirekte), duke përfshirë ngacmimin seksual, dhe e përcaktojnë barazinë e trajtimit në fushat e

⁷ Rezoluta 855 (1986) e Asamblesë Parlamentare për barazinë midis burrave dhe grave, miratuar më 27 janar 1986, në seancën e 21-të.

⁸ Rekomandimi 1229 (1994) i Asamblesë Parlamentare për barazinë e të drejtave midis burrave dhe grave, miratuar më 24 janar 1994, në seancën e parë.

⁹ Rekomandimi 1269 (1995) i Asamblesë Parlamentare për arritjen e progresit real në të drejtat e grave që nga viti 1995, miratuar më 27 prill 1995, në seancën e 15-të.

¹⁰ Rekomandimi 1321 (1997) i Asamblesë Parlamentare për përmirësimin e situatës së grave në shoqërinë rurale, miratuar nga Komiteti i Përhershëm në emër të Asamblesë Parlamentare më 19 mars 1997.

¹¹ Rekomandimi CM/Rec(2003)3 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 mars 2003 në Takimin e 831-të të Zëvendësministrave.

¹² Rezoluta 1489(2006) e Asamblesë Parlamentare mbi mekanizmat për të siguruar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, miratuar nga Komiteti i Përhershëm në emër të Asamblesë Parlamentare më 17 mars 2006.

¹³ Rekomandimi 1899 (2010) i Asamblesë Parlamentare për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë përmes sistemit zgjedhor, miratuar më 27 janar 2010 në seancën e 6-të, 19 mars 1997.

¹⁴ Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në Takimin e 1081-të të Zëvendësministrave..

¹⁵ Rekomandimi CM/Rec(2012)6 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi masat për të luftuar diskriminimin në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 qershor 2012 në Takimin e 1145-të të Zëvendësministrave.

¹⁶ Rekomandimi CM/Rec(2013)1 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi barazinë gjinore dhe mediat, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 10 korrik 2013 në Takimin e 1176-të të Zëvendësministrave.

¹⁷ Rekomandimi CM/Rec(2015)2 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi integrimin e aspektit gjinor në sport, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 janar 2015 në Takimin e 1217-të të Zëvendësministrave; Rekomandimi CM/Rec(2017)9 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare për barazinë gjinore në sektorin audio-vizual, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 shtator 2017 në Takimin 1295-të të Zëvendësministrave; dhe Rekomandimi CM/Rec(2019)1 për parandalimin dhe luftimin e seksizmit, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 mars 2019 në takimin e 1342-të të Zëvendësministrave.

mësipërme (mallrat dhe shërbimet, dhe punësimi), e gjithashtu përqendrohen në mjetet juridike dhe zbatimin e tyre.

14. Nga angazhimet e ndryshme të OSBE-së që përqendrohen në trajtimin e barabartë, Dokumenti i Vjenës është ndoshta një nga më të veçantit që thekson se të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së angazhohen për të siguruar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjithë brenda territorit të tyre dhe i nënshtrohen juridiksionit të tyre, pa dallim të asnjë lloji të bazuar në karakteristika të tilla si, ndër të tjera, gjinia e personit.¹⁸ Ky parim përsëritet në një mënyrë më të detajuar në paragrafin 40.4 të Dokumentit Përfundimtar të Moskës, ku Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e afirmuan qëllimin e tyre për të arritur jo vetëm *de jure*, por gjithashtu *de facto* barazinë e mundësive midis burrave dhe grave, si dhe promovimin e masave efektive për këtë qëllim.¹⁹ Në të njëjtin dokument, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së pranuan se "barazia e vërtetë dhe e plotë midis burrave dhe grave është një aspekt themelor i një shoqërie të drejtë dhe demokratike të bazuar në sundimin e ligjit". Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore i vitit 2004, në Kapitullin e tij IV, gjithashtu u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së të zhvillojnë politika dhe të krijojnë mekanizma për promovimin dhe forcimin e barazisë gjinore, dhe të jenë në përputhje me instrumentet përkatëse ndërkombëtare që i kanë ratifikuar ose në të cilat kanë aderuar.²⁰ Në vitin 2009 në Athinë, Këshilli i Ministrorëve i OSBE-së u bëri thirrje Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së që, ndër të tjera, të marrin në konsideratë masa specifike për të arritur ekuilibrin gjinor në të gjitha institucionet publike dhe të marrin në konsideratë masat e mundshme legislative për të lehtësuar një pjesëmarrje më të ekuilibruar të grave dhe burrave në jetën publike dhe në vendimmarrje.²¹

2. SFONDI

15. Gjatë dekadave të fundit, Maqedonia e Veriut ka krijuar një kornizë të fortë ligjore dhe politike për të përmirësuar barazinë gjinore në vend.²² Aktualisht,²³ gratë përbëjnë 39,17 për qind të Kuvendit, me ç'rast nga gjithsej 120 deputetë, 47 janë gra.²⁴ Në të njëjtën kohë, Doracak për Deputetët dhe Punonjësit e Parlamentit i vitit 2020, i publikuar nga Misioni i OSBE-së në Shkup²⁵, vuri në dukje se megjithëse kuotat gjinore kishin ndihmuar në rritjen e barazisë gjinore në Kuvend dhe në këshillat e nivelit lokal, përfaqësimi i grave në institucionet tjera publike mbeti nën objektivin prej 40 për qind të vendosur nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës Rec(2003)3 i Komitetit të Ministrave

¹⁸ Dokumenti Përfundimtar i OSBE-së i Vjenës - Takimi i Tretë Pasues, Vjenë, 15 janar 1989, Pyetje në lidhje me sigurinë në Evropë, Parimet, paragrafi 13.8.

¹⁹ Dokumenti i Takimit të Moskës i Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE-së, Moskë, 3 tetor 1991, paragrafi 40.

²⁰ Vendimi i Këshillit Ministrorëve të OSBE-së Nr. 14/04 mbi Planin e Veprimit të OSBE-së të vitit 2004 për Promovimin e Barazisë Gjinore i datës 7 dhjetor 2004, Kapitulli 4, paragrafi 42.

²¹ Vendimi i Këshillit Ministrorëve të OSBE-së Nr. 7/09 mbi Pjesëmarrjen politike të grave në jetën politike dhe publike, miratuar më 2 dhjetor 2009.

²² Misioni i OSBE-së në Shkup, Çështjet Gjinore! Doracak për Deputetët dhe Punonjësit e Parlamentit për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, 2020, fq. 18.

²³ Neni 64, paragrafi 5 i Kodit Zgjedhor parashikon që të paktën 40 për qind e kandidatëve në një listë kandidatësh për zgjedhjet parlamentare (por edhe këshillat komunalë) duhet të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar, që do të thotë se "në çdo tre vende të paktën një vend do të rezervohet për gjininë më pak të përfaqësuar, dhe në mënyrë plotësuese edhe së paku nga një vend në çdo dhjetë vende."

²⁴ Shih Bashkimi Ndërparlamentar, Parline - të dhënat globale për parlamentet kombëtare, Maqedonia e Veriut, azhurnimi më i fundit: Tetor 2020, në https://data.ipu.org/node/171/basic-information?chamber_id=13391.

²⁵ Misioni i OSBE-së në Shkup, Çështjet Gjinore! Doracak për Deputetët dhe Punonjësit e Parlamentit për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave, 2020, në fq. 22 thekson se në mars të vitit 2020, nga gjithsej 25 të emëruar në pozita të larta qeveritare vetëm 5 anëtare të qeverisë ishin femra, dhe se, në nivelin lokal, kishte vetëm 6 kryetare të komunave femra nga gjithsej 81 njësi të vetëqeverisjes lokale.

për shtetet anëtare mbi pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike.²⁶

16. Sipas nenit 9 të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut, qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat e tyre, pavarësisht nga, ndër të tjera, gjinia, dhe të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit. Parimi i përgjithshëm i barazisë përsëritet në dispozita të tilla si neni 22 mbi të drejtën e votës, neni 32 mbi të drejtën për punë dhe zgjedhjen e lirë të punësimit dhe neni 44 mbi qasjen në arsim.
17. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i vitit 2020 (në tekstin e mëtejme "Ligji Kundër Diskriminimit")²⁷ i adreson të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe në bazë të seksit, gjinisë, orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Me Ligjin Kundër Diskriminimit u krijua Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi si një organ autonom dhe i pavarur për ankesa dhe përfshin një procedurë të detajuar të ankesave për cilindo që beson se ka përjetuar diskriminim në sektorë të ndryshëm të jetës publike ose private. Ky ligj gjithashtu parashikon mjete të tjera juridike, duke përfshirë mjetet gjyqësore dhe sanksionet.
18. Ligji aktual për Mundësi të Barabarta i vitit 2012, i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2015, synon "krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në sferën politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore, shëndetësore, civile dhe çdo fushë tjetër të jetës shoqërore". Ai përshkruan lloje të ndryshme të masave për të siguruar mundësi të tilla të barabarta dhe rendit subjekte të ndryshme zbatuese publike dhe private dhe detyrimet e tyre sipas ligjit. Për më tepër, Ligji për Mundësi të Barabarta krijon organe të posaçme për të ndihmuar subjektet publike përkatëse të zhvillojnë strategji dhe aktivitete të ndryshme për të siguruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në sferat e tyre përkatëse të punës; kështu, me Ligjin për Mundësi të Barabarta u krijua një Komision i posaçëm për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave në Kuvendin Kombëtar (neni 9), një grup konsultativ dhe këshillimor ndërministror (neni 10) dhe koordinatorë gjinorë në ministrinë dhe në nivelin e vetëqeverisjes lokale (nenet 11 dhe 14), me atë që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale merr rol koordinues dhe mbikëqyrës për të gjitha organet e administratës publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal (neni 12). Kapitulli 5 i rendit elementet kryesore që duhet të përfshihen në Strategjinë e Qeverisë për Barazinë Gjinore, e cila miratohet për një periudhë 8 vjeçare.
19. Ligji për Mundësi të Barabarta gjithashtu përshkruan, në Kapitullin e tij 6, mundësitë për "mbrojtje ligjore" të së drejtës për trajtim të barabartë të grave dhe burrave, që përfshin një procedurë administrative të ankesave, si dhe referime në procedurën e ankesës para Avokatit të Popullit, Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe gjykatat kompetente (neni 20). Ligji për Mundësi të Barabarta në mënyrë plotësuese specifikon që Ministria e Punës dhe Politikës Sociale do ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit, ndërsa mbikëqyrja inspektuese kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës.
20. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e përgatiti Propozim-ligjin aktual, i cili, nëse miratohet, do ta zëvendësojë Ligjin për Mundësi të Barabarta. Ndryshimi kryesor i futur në këtë Propozim-ligj ka të bëjë me çështjen e koordinimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit. Sipas Propozim-ligjit, roli kryesor i koordinimit dhe i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nga organet përgjegjëse të administratës publike në nivelet qendrore dhe lokale tani i takon Sekretariatit të veçantë të krijuar për këtë qëllim nga Qeveria (neni 20), dhe, me disa përjashtime, jo më Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Propozim-ligji

²⁶ Rekomandimi CM/Rec(2003)3 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi pjesëmarrjen e ekuilibruar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 mars 2003 në Takimin e 831-të të Zëvendësministrave.

²⁷ OSBE/ODIHR-i lëshoi një koment mbi Propozim-ligjin e vitit 2018, dhe ai është në dispozicion këtu: [Komentet e OSBE/ODIHR-it mbi Propozim-ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), 21 shkurt 2018

parashikon më tej krijimin e një Qendre Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (neni 25), dhe të një Organi Kombëtar Koordinues për Barazinë Gjinore (neni 26), i cili mund të jetë i ngjashëm me grupin ekzistues konsultativ dhe këshillimor ndër-ministor

3. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË PROPOZIM-LIGJIT Kapitulli i parë i Propozim-ligjit ka të bëjë me dispozitat e përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me qëllimin dhe diapazonin e Propozim-ligjit, si dhe me përkufizimet dhe parimet themelore të Propozim-ligjit. Në nenet 1 dhe 2, thuhet se qëllimi i Propozim-ligjit është sigurimi i barazisë gjinore **“në të gjitha sferat e jetës shoqërore”**. Ky term është disi i paqartë. Nuk është e qartë nëse i mbulon fushat e jetës publike dhe private.²⁸ Është e rëndësishme të përcaktohet saktësisht diapazoni i zbatimit të ligjit, si dhe lloji i fushave publike ose private të jetës në të cilat ai synon të ndikojë. **Përveç nëse mungesa e qartësisë ka të bëjë me versionin në anglisht të Propozim-ligjit, rekomandohet të sqarohet kjo pikë.**

22. Termi "diskriminim" është përcaktuar në nenin 4, paragrafi 21, dhe kryesisht e pasqyron përkufizimin e diskriminimit që gjendet gjithashtu në nenin 6 të Ligjit Kundër Diskriminimit, si dhe elementet kryesore të termit "diskriminimi ndaj grave" siç përcaktohet në nenin 1 të KEGjFDG-së. **Hartuesit e ligjit duhet të sigurojnë që ky përkufizim të jetë i njëjtë edhe në të gjithë legjislacionin tjetër përkatës.** Në të njëjtën kohë, përkufizimi në nenin 4, paragrafi 21 specifikon se ai mbulon aspekte të ndryshme të diskriminimit, duke përfshirë veprimin "për ta bërë të pamundur përshtatjen adekuate dhe për ta bërë të pamundur qasjen dhe disponueshmërinë e infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve". Nuk është e qartë se cilat lloje të sjelljes janë përshkruar këtu, dhe me sa duket kjo pjesë e përkufizimit nuk është në përputhje me pjesën tjetër të përkufizimit, i cili merret me llojet e ndryshme të diskriminimit. **Rekomandohet të sqarohet kjo pjesë e përkufizimit.**
23. Përkufizimi i mësipërm i diskriminimit gjithashtu përfshin ngacmimin dhe ngacmimin seksual, por kuptimet e këtyre dy termave nuk janë shpjeguar. Kjo shënon një ndryshim nga Ligji aktual për Mundësi të Barabarta, i cili, në nenin 4, paragrafët 6 dhe 7, e përcakton edhe ngacmimin me bazë gjinore dhe ngacmimin seksual, respektivisht.
24. Duke pasur parasysh referimet, si në **ngacmimin ashtu edhe në ngacmimin seksual**, në përkufizimin e diskriminimit, **do të ishte më mirë që këto terma të përkufizohen edhe në Propozim-ligj, për të dhënë një pasqyrë të plotë të formave të sjelljes që konsiderohen diskriminuese. Duhet të shihet gjithashtu mundësia për të përcaktuar forma të tjera të diskriminimit të përmendura në nenin 4, paragrafi 21, gjegjësisht diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe indirekt (me ç'rast të dyja janë përcaktuar në nenin 4, paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit për Mundësi të Barabarta), si dhe diskriminimi i shumëfishtë dhe ndërsektorial, ose të bëhet referim në dispozitat përkatëse në ligjet e tjera.**

²⁸ Shih, në këtë kontekst, Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 28 të Komisionit të KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, mbi detyrimet thelbësore të Shteteve palë sipas nenit 2 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW/C/GC/28, 16 dhjetor 2010, paragrafi 25.

REKOMANDIMI A.

Të sqarohet diapazoni i Propozim-ligjit sipas neneve 1 dhe 2, veçanërisht termi "të gjitha sferat e jetës shoqërore".

Të rishikohet, të qartësohet dhe të përmirësohet përkufizimi i termit "diskriminim" sipas nenit 4 të Propozim-ligjit.

4. MASAT PËR BARAZINË GJINORE

25. Kapitulli 2 i Propozim-ligjit merret me masat për barazinë gjinore sipas kuptimit të nenit 7 të KEGjFDG-së. Neni 7 bën dallimin midis masave të përhershme (neni 8) dhe masave të përkohshme (neni 9).²⁹ Në bazë të nenit 7, paragrafi 2, mënyra e planifikimit, miratimit, zbatimit, vlerësimit dhe monitorimit të masave të barazisë gjinore do të përcaktohet nga Qeveria përmes një rregulloreje, e cila do të zbatohet nga të gjitha subjektet dhe individët që e zbatojnë ligjin. Vihet re se nuk ka asnjë informacion se kur do të miratohet rregullorja. **Duhet të shihet mundësia për të sqaruar nëse afati kohor për miratimin e akteve nënligjore brenda 6 muajve pas miratimit të Propozim-ligjit, i përcaktuar në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare në Kapitullin 9 (neni 36), duhet të zbatohet edhe këtu.**
26. Neni 9 i përshkruan masat e përkohshme, të cilat do të merren për të siguruar barazinë e plotë gjinore derisa të arrihet barazia *de facto* e personave ose grupeve në bazë të gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor, me kusht që dallimi përkatës (me gjasë i një grupi të veçantë) të ketë një qëllim legjitim dhe mjetet për ta arritur këtë qëllim të jenë proporcionale. Ato përfshijnë, ndër të tjera, masa që ofrojnë shërbime për të parandaluar dhe mbrojtur nga dhuna ndaj grave. **Në lidhje me këtë të fundit, rekomandohet që kjo të zgjerohet për të mbuluar edhe dhunën me bazë gjinore** në përgjithësi, duke pasur parasysh që masat e përkohshme të përmendura në nenin 9 kanë për qëllim jo vetëm barazinë e mëtejshme midis burrave dhe grave, por edhe barazinë e personave ose të grupeve në bazë të identitetit gjinor ose seksual.
27. **Do të ishte e dobishme të futej një mekanizëm i monitorimit në lidhje me masat e mësipërme**, për të vlerësuar nëse ato funksionojnë në praktikë dhe për të identifikuar fushat që duhet të përmirësohen.


REKOMANDIMI B.

Të konsiderohet mundësia për të përcaktuar në Propozim-ligj afatin brenda të cilit duhet të miratohet rregullorja sipas nenit 7 paragrafi 2 (dhe rregulloret e tjera).

Të konsiderohet rishikimi i nenit 9 mbi masat e përkohshme, për të siguruar që masat e tilla miratohen jo vetëm për të rritur barazinë midis burrave dhe grave, por edhe barazinë për personat ose grupet në bazë të identitetit gjinor ose seksual.

Të futet një mekanizëm monitorimi për masat e përhershme dhe të përkohshme për të vlerësuar nëse ato funksionojnë në praktikë.

²⁹ Shih, në këtë kontekst, Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 25 të Komisionit të KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, për nenin 4, paragrafi 1 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, mbi masat e posaçme të përkohshme.



5. SUBJEKTET DHE MEKANIZMAT PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN E MASAVE TË BARAZISË GJINORE

28. Propozim-ligji përgjithësisht ruan një numër pikëpamjesh dhe organesh për barazinë gjinore që ekzistojnë tashmë për të ndihmuar në zbatimin e Ligjit për Mundësi të Barabarta, veçanërisht Komisionin për Barazi Gjinore në kuadër të Kuvendit, dhe koordinatorët e barazisë gjinore dhe zëvendësit e tyre në kuadër të ministrive dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore dhe njësisve të vetëqeverisjes lokale, si dhe komisionet për barazi gjinore në kuadër të njësisve të tilla.
29. Përveç organeve të mësipërme, Propozim-ligji krijon edhe organe të reja të barazisë gjinore në kuadër të pushtetit ekzekutiv për të ndihmuar në zbatimin e ligjit, edhe atë Sekretariatit për Barazinë Gjinore, Qendrën Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor dhe Organin Koordinues Kombëtar për Barazinë Gjinore. Kjo duket se i ndjek rekomandimet e Komisionit të KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (në tekstin e mëtejshëm "Komisioni KEGjFDG"), i cili përsëriti, në vëzhgimet e tij përfundimtare të raportit periodik të vitit 2018 për Maqedoninë e Veriut, se është thelbësore që shtetet të sigurojnë që KEGjFDG të zbatohet nga autoritetet publike, në të gjithë sektorët dhe në të gjitha nivelet.³⁰ Nën-seksionet pasuese do të merren me disa nga organet ekzistuese dhe ato të reja në më shumë detaje.

5.1. Komisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore

30. Sipas nenit 13, paragrafi 1 (6) të Propozim-ligjit, Kuvendi formon Komisionin për Barazi Gjinore si një organ i përhershëm punues dhe e përcakton përbërjen dhe kompetencat e tij. Një dispozitë e ngjashme ekziston në nenin 9, paragrafi 4 të Ligjit aktual për Mundësi të Barabarta. Sipas nenit 13, paragrafi 4, Kuvendi është i detyruar të zbatojë parimin e pjesëmarrjes së ekuilibruar kur përcakton përbërjen e organeve të tij të punës.
31. Neni 14, në paragrafin 1 të tij, në thelb e përsërit përbajtjen e nenit 13, paragrafi 1 (6), pa ofruar informacion shtesë për kriteret e mundshme për emërimin e anëtarëve në këtë Komision. **Prandaj, rekomandohet ose të specifikohen kriteret e tilla më në hollësi në nenin 14, ose të fshihet paragrafi i tij i parë si i tepërt.**
32. Për më tepër, nuk është e qartë se kujt i referohet saktësisht "parimi i pjesëmarrjes së ekuilibruar" që përmendet në nenin 13, paragrafi 4, dhe në veçanti se çfarë lloji i ekuilibrit nënkuptohet - politik, gjinor, ose të dyja. Në përgjithësi, një përbërje e larmishme dhe më e ekuilibruar gjinore brenda Komisionit do të ishte e mirëpritur, duke pasur parasysh që përbërjet aktuale dhe të kaluara të Komisionit zbulojnë një përqindje të lartë disproporcionale të grave.
33. Në të njëjtën kohë, nëse parimi i pjesëmarrjes së ekuilibruar i përmendur në nenin 13, paragrafi 4, në fakt i referohet parimit të pjesëmarrjes së ekuilibruar të përcaktuar në

³⁰ Komisioni i KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Vëzhgimet Përfundimtare të raportit të gjashtë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, CEDAW/MKD/CO/6, 14 nëntor 2018, paragrafi 10.

nenin 6, paragrafi 3 dhe përcaktimit të përfaqësimit të barabartë sipas nenit 4, paragrafi 1 (13), atëherë kjo do të nënkuptonte se të gjitha organet punuese të Kuvendit, duke përfshirë edhe Komisionin, do të duhet të arrijnë dhe mbajnë një përqindje të burrave dhe grave që është jo më pak se përqindja e secilës gjini në popullsinë e përgjithshme. Është e diskutueshme nëse, të paktën në këtë moment, arritja e këtij lloji të kuazi-barazisë së burrave dhe grave në të gjitha organet punuese të Kuvendit është reale, dhe mos ndoshta është më e dobishme të rishikohen këto dispozita të ndryshme me qëllim që të vendosen qëllime që janë disi më të arritshme.

34. Për më tepër, neni 13 nuk përmban ndonjë kriter që do të ofronte një tregues se kur ekuilibri i tillë do të konsiderohej se është përmbushur. **Do të ishte mirë nëse kjo, dhe e gjithë çështja e pjesëmarrjes së ekuilibruar, mund të sqarohet në Propozim-ligj.**
35. Sa i përket kompetencave të Komisionit, vihet re se neni 14, paragrafi 2 tashmë ofron një listë gjithëpërfshirëse të detyrave dhe kompetencave, kështu që nuk është e qartë se cilat kompetenca shtesë do t'i përcaktojë Kuvendi Kombëtar në bazë të nenit 13, paragrafi 1 (6) dhe nenit 14, paragrafi 1. **Sqarimet e mëtejshme të kësaj pike do të kontribuonin në dispozitat përkatëse**
36. Për më tepër, vihet re se neni 9, paragrafi 5 i Ligjit për Mundësi të Barabarta ofron disa kompetenca shtesë për Komisionin, të cilat nuk janë përfshirë në nenin 14, paragrafi 2 të Propozim-ligjit, përkatësisht rishikimin e propozim-ligjeve dhe rregulloreve të tjera të miratuara nga Kuvendi, duke përfshirë edhe buxhetin, për sa i përket përfshirjes së konceptit gjinor në to. Kjo natyrisht mund të shihet se bie nën detyrimin e përgjithshëm të integritetit gjinor që i përfshin të gjitha subjektet publike në bazë të nenit 10, paragrafi 1. Megjithatë, **sugjerohet që, për hir të plotësisë, të shtohet në mënyrë specifike rishikimi i propozim-ligjeve në listën e kompetencave të Komisionit sipas nenit 14, paragrafi 2.**

REKOMANDIMI C.

Të qartësohet kuptimi i parimit të pjesëmarrjes së ekuilibruar, që do të merret parasysh në lidhje me përbërjen e organeve punuese parlamentare sipas nenit 13, paragrafi 4.

Të rishikohet dhe të përmirësohet lista e kompetencave të Komisionit sipas nenit 14, paragrafi 2.

5.2. Organet e Barazisë Gjinore në kuadër të pushtetit ekzekutiv

37. Ashtu si në Ligjin aktual për Mundësi të Barabarta (neni 11, paragrafi 4), neni 16, paragrafi 2 i Propozim-ligjit parashikon punësimin e këshilltarëve/koordinatorëve specialë për çështjet e barazisë gjinore në ministri dhe institucionet e administratës shtetërore. Propozim-ligji specifikon se këto do të jenë poste me kohë të plotë të punës; sipas nenit 7 të Dekretit Qeveritar të vitit 2014 për Përshkrimin e Kategorive dhe Niveleve të Vendeve të Punës së Nëpunësve Administrativë, të miratuar sipas nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit për Nëpunësit Administrativë, vendi përkatës i punës i specifikuar në Propozim-ligj është për nëpunësit udhëheqës administrativë, të cilët janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre dhe që i raportojnë drejtpërdrejt sekretarit të institucioni publik. Ky vend i lartë i pozitës së këshilltarit/koordinatorit gjinor synon të sigurojë që nëpunësit shtetërorë përkatës të mund t'i përmbushin në mënyrë efektive detyrat e tyre si koordinatorë ekspertë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit.

38. Neni 24 i Propozim-ligjit parashikon një Sekretariat të ri për Barazi Gjinore që do të themelohet nga Qeveria. Qëllimi kryesor i Sekretariatit është ta koordinojë punën e Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore që e zbatojnë ligjin, duke i përfshirë edhe organet e vetëqeverisjes lokale. Në këtë mënyrë, ai merr përsipër detyra që aktualisht i takojnë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (neni 12 i Ligjit për Mundësi të Barabarta).
39. Krijimi i një Sekretariati të tillë si një organ i veçantë në kuadër të pushtetit ekzekutiv për të koordinuar dhe monitoruar punën e të gjitha ministrive dhe organeve administrative në lidhje me promovimin e barazisë gjinore dhe zbatimin e ligjit kërkon të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore në organizimin e brendshëm të pushtetit ekzekutiv, e po ashtu **duhet të bëhet më i qartë vendi i tij brenda strukturës ekzekutive**. Krijimi i Sekretariatit gjithashtu duket se ndjek rekomandimin e Komisionit të KEGjFDG të vitit 2018 për të forcuar kapacitetin vendimmarrës dhe autoritetin e organit koordinues përkatës në Maqedoninë e Veriut (në atë kohë ende Njësia për Mundësi të Barabarta në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale) dhe të konsiderohet mundësia për ta avancuar atë në nivel ministror për të funksionuar në mënyrë efektive si makineri kombëtare për përparimin e grave.³¹
40. Në të njëjtën kohë, **duhet të ndahen mjete të mjaftueshme financiare për personelin e këtij Sekretariati që duhet të jetë shumë i kualifikuar në fushën e barazisë gjinore, dhe gjithashtu të sigurohet trajnim i mjaftueshëm për barazinë gjinore dhe integrimin gjinor për të siguruar që koordinimi i çështjeve të barazisë gjinore përmes këtij organi të ri të zhvillohet pa pengesa**.³²
41. Nëse, siç specifikohet në nenin 24 të Propozim-ligjit, Sekretariati tani është organi kryesor koordinues dhe monitorues në fushën e barazisë gjinore, është e paqartë pse, sipas nenit 16, paragrafi 4 dhe nenit 19, paragrafi 10, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale duhet të përshkruajë formën dhe përmbajtjen e raporteve vjetore që ministrinë dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet t'ia dorëzojnë Sekretariatit sipas nenit 16, paragrafi 1 (9) dhe nenit 19, paragrafi 6. **Do të ishte më në përputhje me përjasjen e re të përdorur në Propozim-ligj që Sekretariati ta përshkruajë formën dhe përmbajtjen e këtyre raporteve; dispozitat përkatëse duhet të përshtaten në përputhje me këtë**.
42. Neni 25 i Propozim-ligjit krijon një Qendër të re Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor, si një hap i domosdoshëm për të siguruar që metodologjitë dhe teknikat kryesore në lidhje me këtë lloj të hartimit të politikave dhe të buxhetimit të promovohen dhe të mësohen brenda organeve përkatëse publike. Në të njëjtën kohë, **është e rëndësishme të përcaktohen qartë rolet dhe kompetencat e kësaj Qendre Burimore dhe të Sekretariatit për të shmangur mbivendosjen dhe mandatet kundërshtuese**. Për shembull, duhet të sqarohet se cili organ është përgjegjës për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapaciteteve brenda shërbimit civil, që janë elemente thelbësore për ta bërë Propozim-ligjin funksional pasi të miratohet.
43. **Rekomandohet të specifikohet se ku do të vendoset ky organ brenda administratës shtetërore, veçanërisht a do të jetë pjesë e Sekretariatit apo një organ i pavarur, dhe si do të bashkëpunojë me Sekretariatin dhe me ministrinë dhe organet e tjera të**

³¹ Komisioni i KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Vëzhgimet Përfundimtare të raportit të gjashtë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, CEDAW/C/MKD/CO/6, 14 nëntor 2018, paragrafi 16.

³² Siç rekomandohet gjithashtu në: Vëzhgimet Përfundimtare të raportit të gjashtë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë të Komisionit të KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW/C/MKD/CO/6, 14 nëntor 2018, paragrafi 16.

administratës publike për të siguruar që të ketë informacion të mjaftueshëm praktik për hulumtimet e tij të mëtejshme.

44. Për më tepër, neni 26 e ngarkon Qeverinë me krijimin e një Organi Kombëtar Koordinues për Barazinë Gjinore, i cili, bazuar në paragrafin 4 të kësaj dispozite, përfshin anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, shoqatave të punëdhënësve, sindikatave dhe ekspertë, të zgjedhur me anë të shpalljes publike. Organi Kombëtar Koordinues do të kryesohet nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale (neni 26 paragrafi 6).
45. Natyra dhe kompetencat e këtij organi nuk janë specifikuar në nenin 26. Bazuar në atë që dihet për përbërjen e tij, supozohet se ky organ është i ngjashëm me grupin ndër-ministral konsultativ dhe këshillimor të përshkruar aktualisht në nenin 10, paragrafët 6-8 të Ligjit për Mundësi të Barabarta. Aktualisht, në bazë të ligjit, grupi ndër-ministral konsultativ dhe këshillimor ka për detyrë të promovojë dhe të monitorojë përfshirjen e aspekteve gjinore në politikat e përgjithshme të të gjitha institucioneve publike, në bashkëpunim me partnerët socialë, si dhe të monitorojë progresin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, duke dhënë udhëzime në procesin e përgatitjes së Strategjisë së Barazisë Gjinore dhe të monitorojë raportet periodike nga institucionet.
46. Për të sqaruar rolin që duhet të luajë Organi Kombëtar Koordinues, **do të ishte e dobishme nëse detyrat dhe kompetencat e tij do të përshkruheshin në nenin 26 të Propozim-ligjit. Në mënyrë të ngjashme, kjo dispozitë duhet të sqarojë nëse, përveç Ministrisë të Punës dhe Politikës Sociale, ndonjë nëpunës tjetër shtetëror do të jetë pjesë e këtij organi, dhe nëse po, kush duhet të jenë ata.** Këtu, duhet të kihet parasysh se aktualisht, në grupin ndër-ministral konsultativ dhe këshillimor marrin pjesë funksionarë/nëpunës shtetërorë në pozita udhëheqëse, së bashku me organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e punëdhënësve, ekspertët, përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, sindikatat dhe subjektet e tjera. Për më tepër, **do të ishte e dobishme të specifikohen rolet e ndryshme që i luajnë Organi Kombëtar Koordinues dhe Sekretariati, dhe mënyrën se si këto dy organe do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre. Anëtarëve të këtij organi, burrave dhe grave, gjithashtu duhet t'u ofrohen module të trajnimit për çështje të ndryshme të barazisë gjinore.**
47. Në fund, **neni 26 duhet të përcaktojë nëse Udhëheqësi i Sekretariatit, ose ndonjë anëtar tjetër i Sekretariatit duhet të jetë gjithashtu anëtar i Organi Kombëtar Koordinues, gjë që mund të jetë e dobishme në aspektin e koordinimit midis dy organeve.**

REKOMANDIMI D.

Të sqarohet se ku do të vendoset Sekretariati, i krijuar sipas nenit 24, dhe të sigurohen mjete financiare dhe trajnime të mjaftueshme për të siguruar se ai është në gjendje t'i përmbushë siç duhet detyrat e tij.

Të rishikohet roli i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në lidhje me raportimin në nenin 16, paragrafi 4 dhe nenin 19, paragrafi 10

Të përcaktohet qartë roli dhe kompetencat e Qendrës Burimore për Hartimin e Politikave dhe Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në nenin 25 dhe të sqarohet se ku do të vendoset ajo brenda administratës shtetërore dhe si do të bashkëpunojë me Sekretariatit dhe organet e tjera publike, duhet të sigurohen burime të mjaftueshme për të siguruar efektivitetin e këtij organi;

Të përshkruhen detyrat dhe kompetencat e Organit Kombëtar Koordinues në nenin 26, të specifikohet se si ndryshojnë ato nga detyrat dhe kompetencat e Sekretariatit dhe të sqarohet se si do të bashkëpunojnë këto dy organe.

5.3 Organet e barazisë gjinore në nivelin lokal

48. Në nivelin lokal, neni 19 i përshkruan kompetencat dhe detyrat e njësive të vetëqeverisjes lokale në bazë të Propozim-ligjit, e gjithashtu përcakton, nën paragrafin 8 të tij, pozitën e këshilltarit/koordinatorit për barazinë gjinore dhe zëvendësit të tij, të cilët do të përmbushin detyra të ngjashme në nivelin lokal, sikurse homologët e tyre në ministri dhe në organet e administratës publike në nivelin qendror. Këto lloje këshilltarësh/koordinatorësh janë përfshirë tashmë në Ligjin aktual për Mundësi të Barabarta sipas nenit 14, paragrafi 8.
49. Në këtë kontekst, vihet re se në vëzhgimet e tij përfundimtare të raportit të gjashtë periodik për Maqedoninë e Veriut të vitit 2018, Komisioni KEGjFDG kishte ngritur shqetësime në lidhje me efektivitetin e kufizuar të Ligjit për Mundësi të Barabarta, veçanërisht në nivelin komunal.³³ Në Propozim-ligj, neni 20 e përshkruan natyrën dhe detyrat e Komisionit për Barazinë Gjinore të krijuar në secilën njësi të vetëqeverisjes lokale. Komisione të ngjashme janë paraparë në nenin 14, paragrafët 5 dhe 6 të Ligjit aktual për Mundësi të Barabarta, dhe është për t'u mirëpritur fakti që aktivitetet e këtyre organeve tani përshkruhen më në hollësi në Propozim-ligj, gjë që mund të ndihmojë që këto organe të bëhen më efektive. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale duhet të ndryshohet për të pasqyruar ekzistencën e komisioneve të tilla** (përveç nëse propozim-ligji përkatës është përgatitur tashmë). Për më tepër, **mund të jetë e dobishme të merret parasysh mbajtja e sesioneve të rregullta të trajnimit për burrat dhe gratë që janë anëtarë të këtyre komisioneve për çështjet përkatëse të barazisë gjinore.**
50. Neni 20, paragrafi 2 përcakton që anëtarët e jashtëm, përfaqësuesit e shoqatave, partnerët socialë dhe të tjerët mund të marrin pjesë në punën e komisioneve. **Megjithatë, do të ishte e dobishme të specifikohet në këtë dispozitë se si zgjidhen këta anëtarë të jashtëm, dhe a do të ishin anëtarë të përhershëm të komisioneve, apo do të ftoheshin në seanca të caktuara mbi baza *ad hoc* (dhe nëse po, duke u bazuar në cilat kritere).**

REKOMANDIMI E.

Të shtohen referime për komisionet lokale të barazisë gjinore në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe të sqarohet pjesëmarrja në komisione të tilla sipas nenit 20, paragrafi 2.

Të parashikohen sesione të rregullta trajnimit për burrat dhe gratë që janë anëtarë të komisioneve për barazi.

5.4 Subjektet e tjera që e zbatojnë ligjin

51. Përveç Kuvendit Kombëtar dhe administratës publike, Propozim-ligji i përshkruan gjithashtu rolet e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (në tekstin e mëtejme

- "IKDNj"), të mediave dhe të partive politike në zbatimin e ligjit, në nenet 21, 22 dhe 23 respektivisht. Këto subjekte gjithashtu përmenden në nenet 12, 16 dhe 17 të Ligjit aktual për Mundësi të Barabarta.
52. Sipas nenit 21, është parashikuar që Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi "të marrin masa për parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe burrave në përputhje me ligjin" dhe do të emërojnë koordinatorë dhe zëvendës koordinatorë nga radhët e punonjësve të tyre për këtë qëllim. Ashtu si në rastin e nenit aktual 12 të Ligjit për Mundësi të Barabarta, **mund të jetë e dobishme të specifikohen gjithashtu rolet e IKDNj-ve si mekanizma për shqyrtimin e ankesave në fushën e diskriminimit në bazë të gjinisë, seksit ose identitetit gjinor, ose të përfshihen referime në ligjet përkatëse. Për më tepër, duhet të gjenden burime të mjaftueshme dhe të sigurohet trajnimi i duhur për ata punonjës të emëruar si koordinatorë dhe zëvendës koordinatorë që nga fillimi, për të siguruar se ata do të jenë në gjendje t'i përmbushin detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.**³⁴
53. Për më tepër, vihet re se megjithëse neni 14 për Komisionin për Barazinë Gjinore të Kuvendit Kombëtar, dhe dispozitat përkatëse për këshilltarët/koordinatorët për barazi gjinore në ministrinë/organet e administratës publike dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale (nenet 16 dhe 19) janë shumë specifike për bashkëpunimin me organet e tjera, **IKDNj-të nuk janë përfshirë në mesin e këtyre organeve; kjo duhet të korrigjohet.**
54. Për sa i përket mjeteve të informimit publik, neni 22, paragrafi 2 specifikon se personat duhet të prezantohen në mjetet e informimit publik në mënyrë "jo ofenduese, jo nënçmuese ose jo degraduese, në bazë të gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor, si dhe të mos veprojnë në drejtim të vazhdiminimit të ideve të inferioritetit të grave ose rreth roleve stereotipike të grave dhe burrave ose role të tjera stereotipike që lidhen me gjininë, seksin dhe identitetin gjinor". Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike përmendet si një organ monitorimi që duhet të shqyrtojë dhe të raportojë mbi mënyrën në të cilën burrat dhe gratë paraqiten dhe prezantohen në konceptet dhe përmbajtjet e programeve mediatike.
55. Megjithëse kjo përpjekje për të zvogëluar portretizimet negative, diskriminuese ose degraduese të grave është pozitive si e tillë, është e rëndësishme të sigurohet që një monitorim i tillë të mos çojë në ndërhyrje ose censurë të padrejtë të mediave. Për më tepër, për shkak të natyrës tepër të gjerë të nenit 22, paragrafi 2, është e vështirë të imagjinohet se si kjo lloj dispozite mund të zbatohet në praktikë pa ndërhyrje në mënyrë të padrejtë në autonominë dhe liritë, veçanërisht në lirinë e shprehjes, të mediave. Kështu, për shembull, përshtatimi i roleve stereotipike në lidhje me gjininë, seksin dhe identitetin gjinor në raportimin ose prodhimin e mediave nuk është e thënë që domosdoshmërisht ka për qëllim degradimin ose poshtërimin. Në këtë kontekst, rikujtohet gjithashtu se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka specifikuar se liria e shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së mbron jo vetëm "informacionin ose idetë që pranohen si të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiference, por edhe ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë".³⁵ **Prandaj, rekomandohet të rishikohen dispozitat e mësipërme dhe ato të ndryshohen ose të fshihen për të siguruar pajtueshmëri me standardet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.**
56. Neni 23 i Propozim-ligjit i detyron partitë politike të monitorojnë dhe të raportojnë se si gratë dhe burrat përfaqësohen në strukturat e tyre të brendshme. Përveç kësaj, partitë

³⁴ Siç rekomandohet gjithashtu në Vëzhgimet Përfundimtare të raportit të gjashtë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, të Komisionit të KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW/C/MKD/CO/6, 14 nëntor 2018, paragrafi 18.

³⁵ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 5493/72, aktgjykimi i datës 7 dhjetor 1976, paragrafi 49 dhe *Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13585/88, aktgjykimi i datës 6 nëntor 1991, paragrafi 59.

politike janë të detyruara të përgatisin programe për promovimin e barazisë gjinore, t'i publikojnë ato në ueb-faqet e tyre dhe të bëjnë revizione të rregullta gjinore.

57. Shumë palë në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe në vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë futur në mënyrë të qartë mundësinë ose madje edhe obligimin për të futur masa të veçanta për të siguruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat për të marrë pjesë në proceset partiake. Këto masa të veçanta nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese.³⁶ Partitë politike mund të futin, për shembull, dispozita në statutet e tyre për të promovuar barazinë gjinore. Këto mund të përfshijnë, për shembull, një përfaqësim minimal të secilës gjini ose seksione të grave në strukturat vendimmarrëse, listat zgjedhore, nominimet dhe emërimet. Për më tepër, barazia gjinore mund të përmendet si një vlerë themelore në statutet, politikat dhe programet e partive.³⁷
58. Megjithëse qëllimi i përmirësimit të barazisë gjinore brenda partive politike është i mirëpritur edhe këtu, është e rëndësishme që detyrimet e vendosura nga legjislacioni, të tilla si revizionet e detyrueshme, të mos e cenojnë padrejtësisht autonominë e partive politike, e cila mbrohet nga e drejta e tyre për liri të bashkimit.³⁸ **Prandaj, rekomandohet të rishikohet kjo dispozitë dhe të sigurohet pajtueshmëria e Propozim-ligjit me standardet kryesore të lirisë së bashkimit.**

REKOMANDIMI F.

Të specifikohen gjithashtu rolet e IKDNj-ve si mekanizma për shqyrtimin e ankesave në fushën e diskriminimit në bazë të gjinisë, seksit ose identitetit gjinor në Propozim-ligj, ose të përfshihen referime në ligjet përkatëse; të sigurohet se janë alokuar burime të mjaftueshme për IKDNj-të, së bashku me trajnimet e duhura, për të siguruar se ato mund t'i përmbushin rolet e tyre në përputhje me Propozim-ligjin.

Të përmirësohen nenet 14, 16 dhe 19 të Propozim-ligjit duke përfshirë referim për bashkëpunimin me IKDNj-të për organet përkatëse të barazisë gjinore; dispozita të ngjashme duhet të futen për organet e krijuara rishtazi të specifikuar në Propozim-ligj.

Të rishikohen nenet 22 dhe 23 për të siguruar që monitorimi i mediave dhe detyrimet e vendosura për partitë politike janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

6. MJETET JURIDIKE DHE SANKSIONET

59. Kapitulli 6 i Propozim-ligjit i përshkruan mënyrat e mbrojtjes gjyqësore për personat që besojnë se janë shkelur të drejtat e tyre për trajtim të barabartë në bazë të gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor (neni 27, paragrafi 1). Kjo ndryshon nga neni 20 i Ligjit aktual mbi Mundësitë e Barabarta, i cili siguron jo vetëm mjete juridike gjyqësore, por edhe një

³⁶ Komisioni KEGjFDG, Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 23: Jeta politike dhe publike (1997), A/52/38/Rev.1, paragrafi 47, i cili thotë se detyrimi për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit në të gjitha fushat e jetës publike dhe politike përfshin masa të tilla që janë të dizajnuara për të: "Inkurajuar organizatat joqeveritare dhe shoqatat publike dhe politike të miratojnë strategji që inkurajojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në punën e tyre."

³⁷ Shih Udhëzimet e Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike të lëshuara nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) në vitin 2020 (botimi i 2-të), paragrafi 160.

³⁸ Shih Udhëzimet e Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike të lëshuara nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) në vitin 2020 (botimi i 2-të), të cilat specifikojnë se funksionet dhe proceset e brendshme të partive politike duhet të jenë përgjithësisht të lira nga ndërhyrjet e shtetit dhe se kontrolli i shtetit mbi partitë politike duhet të mbetet në minimum (paragrafët 151 dhe 154).

procedurë administrative për ankesa, si dhe procedura para Avokatit të Popullit dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në raste të tilla.

60. Për hir të plotësisë, **është e këshillueshme që në Propozim-ligj të përfshihen mjetet juridike ose mekanizmat e mundshëm për ankesa, dhe/ose të ketë referime në legjislacionin përkatës, si dhe të përfshihen referime të veçanta në mekanizmat për ankesa para IKDNJ-ve.**
61. Për më tepër, është e paqartë pse është hequr mjeti juridik administrativ për ankesa në lidhje me trajtimin e pabarabartë (i përcaktuar aktualisht në nenet 20-32 të Ligjit për Mundësi të Barabarta), duke pasur parasysh se kjo do t'u jepte organeve të administratës publike mundësinë për t'i korrigjuar rregullat dhe praktikat e mundshme diskriminuese, dhe në atë mënyrë mund të ndihmojnë edhe në rritjen e vetëdijes për çështjet e barazisë gjinore brenda administratës publike. Përveç kësaj, ky lloj i mekanizmit administrativ për ankesa do të ndihmonte gjithashtu në zvogëlimin e numrit të rasteve që janë në pritje para gjykatave. **Rekomandohet që palët e interesuara përkatëse dhe vendimmarrësit ta rivlerësojnë këtë çështje dhe ta konsiderojnë mundësinë për rivendosjen e një sistemi administrativ për ankesa.**
62. Në lidhje me mjetet juridike gjyqësore të përshkruara në Kapitullin 6 të Propozim-ligjit, vihet re se kjo kryesisht i reflekton paditë kundër diskriminimit të përshkruara në Ligjin Kundër Diskriminimit, duke përfshirë edhe zhvendosjen e barrës së provës, që është e mirëseardhur. **Masat mbrojtëse të mëtejshme mund të përfshijnë njëfarë mbrojtje ose imunitet për dëshmitarët që punojnë në personat juridikë përkatës dhe që japin deklarata para gjykatës në emër të viktimave, si dhe klauzola të përgjithshme për mbrojtjen e informatorëve (denoncuesve)..**
63. **Në të njëjtën kohë, duhet të shihet mundësia që në Propozim-ligj të shtohen referime në elementet shtesë të këtyre padive kundër diskriminimit, të tilla si, p.sh., mundësia për padi *actio popularis* (neni 35 i Ligjit Kundër Diskriminimit) dhe pjesëmarrja e palëve të treta në padi (neni 40 i Ligjit Kundër Diskriminimit). Gjithashtu, ofrimi i ndihmës juridike mund të ndihmojë, nëse nuk ofrohet tashmë, që personat nga zonat rurale, me të ardhura të ulëta ose persona të tjerë të pafavorizuar, gjithashtu të kenë qasje në mjetet e duhura juridike gjyqësore.**
64. Kundërvajtjet dhe gjobat përkatëse të përshkruara në nenin 32 nën Kapitullin 7 të Propozim-ligjit kryesisht kanë të bëjnë me dështimin e subjekteve publike ose subjekteve të tjera për të përmbushur kërkesat e tyre në lidhje me punësimin e këshilltarëve/koordinatorëve të veçantë, ose kërkesat e raportimit, por nuk ofrojnë ndonjë informacion mbi llojet e gjobave që subjektet ose personat fizikë mund të pritet t'i paguajnë nëse i shkelin të drejtat e personave për trajtim të barabartë sipas nenit 27. Me sa duket, kjo është për shkak të faktit se hartuesit kanë dashur t'i zhvendosin të gjitha pretendimet për diskriminim në Ligjin Kundër Diskriminimit, por duket se është jokonsekuente të parashikohen mjete juridike për trajtim të pabarabartë në bazë të gjinisë, seksit ose identitetit gjinor sipas nenit 27, e më pas të mos ofrohet asnjë informacion mbi llojet e sanksioneve që mund të pësohen për shkak të sjelljes së tillë. **Do të ishte më e qartë dhe më e pajtueshme me parimet e ligjshmërisë dhe të parashikueshmërisë së legjislacionit, nëse gjobitjet e tilla do të futeshin përsëri në Propozim-ligj, ose nëse mund të bëhen referime në rregullat specifike për kundërvajtje që zbatohen në raste të tilla, në vend të referimeve më të përgjithshme të përfshira në nenet 34 dhe 35 të Propozim-ligjit.**

REKOMANDIMI G.

Të rivendosen të gjitha mekanizmat e mundshëm për mjetet ligjore dhe ankesat në Propozim-ligj, duke përfshirë referimet në mekanizmat e shqyrtimit të ankesave para IKDNJ-ve.

Të vlerësohet dhe të konsiderohet rivendosja e një mekanizmi administrativ për ankesa sipas këtij Propozim-ligji, ose të përfshihen referime në ligjet përkatëse.

Të shtohen masa të caktuara mbrojtëse në procedurat gjyqësore dhe referime në elementet shtesë të përdorura në paditë gjyqësore sipas Ligjit Kundër Diskriminimit, të tilla si padi *actio popularis* (padi për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik) dhe pjesëmarrje të palëve të treta, dhe të parashikohet ndihmë juridike për procedurat e tilla, sipas nevojës.

Të rishikohen dhe të ofrohen detaje të mëtejshme mbi sanksionet siç janë llojet e ndryshme të gjobave në Propozim-ligj ose të ketë referime në rregullat specifike për kundërvajtje që zbatohen në raste të tilla.

7. REKOMANDIME NË LIDHJE ME PROCESIN E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PROPOZIM-LIGJIT

7.1. Vlerësimi i ndikimit dhe qasja pjesëmarrëse

65. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar të sigurojnë që legjislacioni do të "miratohet në fund të një procedure publike dhe [se] rregulloret do të publikohen, duke qenë ky kusht për zbatueshmërinë e tyre" (Dokumenti i Kopenhagës i vitit 1990, paragrafi 5.8).³⁹ Për më tepër, angazhimet kryesore specifikojnë që "legjislacioni do të formulohet dhe do të miratohet si rezultat i një procesi të hapur që reflekton vullnetin e njerëzve, qoftë drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur" (Dokumenti i Moskës i vitit 1991, paragrafi 18.1).⁴⁰ Lista e kontrollit për sundimin e ligjit e Komisionit të Venedikut gjithashtu thekson se publiku duhet të ketë një mundësi domethënëse për të dhënë kontribut.⁴¹ Siç rekomandohet posaçërisht në Vlerësimin e fundit Paraprak të Procesit Legjislativ në Republikën e Uzbekistanit të OSBE/ODIHR-it, "konsultimet publike duhet të bëhen një veçori rutinore [dhe një] pjesë kuptimplote e çdo faze të procesit legjislativ, veçanërisht në Dhomën Legjislative".⁴²
66. Kuptohet që hartuesit e ligjit kanë konsultuar një numër të palëve të interesuara gjatë përgatitjes së Propozim-ligjit, duke përfshirë pjesë të ndryshme të pushtetit ekzekutiv, si dhe Institutin për të Drejtat e Njeriut, Avokatin e Popullit dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Gjithashtu u konsultuan edhe Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Zyra e Komisionerit të Lartë të KB-ve për të Drejtat e Njeriut. Kjo është një qasje e mirëpritur që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së.
67. Që konsultimet mbi propozim-ligjet të jenë efektive, ato duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijnë konsultime dhe komente nga publiku, duke përfshirë edhe shoqërinë

³⁹ Gjendet në <<http://www.osce.org/fr/odihr/elections/14304>><<http://www.osce.org/fr/odihr/elections/14304>>

⁴⁰ Gjendet në <<http://www.osce.org/fr/odihr/elections/14310>><<http://www.osce.org/fr/odihr/elections/14310>>

⁴¹ Shih Komisioni i Venedikut, *Lista e kontrollit për sundimin e ligjit*, CDL-AD(2016)007, Pjesa II.A.5.

⁴² Shih OSBE/ODIHR, *Vlerësimi paraprak i procesit legjislativ në Republikën e Uzbekistanit* (11 dhjetor 2019), Rekomandimi N.

civile.⁴³ Ato gjithashtu duhet të sigurojnë kohë të mjaftueshme për palët e interesuara që të përgatisin dhe të dorëzojnë rekomandime mbi propozim-ligjin, ndërsa shteti duhet të krijojë një mekanizëm adekuat dhe në kohë për informacion kthyes, me ç'rast autoritetet publike duhet t'i njohin dhe t'u përgjigjen kontributeve të dhëna, duke ofruar arsytetime të qarta për përfshirjen ose mos përfshirjen e komenteve/propozimeve të caktuara.⁴⁴ Për të garantuar pjesëmarrje efektive, mekanizmat e konsultimit duhet të mundësojnë dhënien e kontributit në fazë të hershme *dhe gjatë gjithë procesit*,⁴⁵ që do të thotë jo vetëm kur propozim-ligji përgatitet nga ministrinë përkatëse, por edhe kur diskutohet para parlamentit (p.sh., përmes organizimit të debateve publike). Megjithëse gatishmëria për të organizuar konsultime publike gjatë gjithë procesit të hartimit të ligjeve është e mirëseardhur, modalitetet e konsultimeve publike dhe çështja se a ekziston një mekanizëm i duhur dhe në kohë për informacion kthyes është po aq e rëndësishme dhe përcakton nëse konsultimet publike ishin apo do të jenë efektive dhe gjithëpërfshirëse siç u përmend më lart.

68. Duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm të Propozim-ligjit mbi ushtrimin e barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjitha gjinitë, një vlerësim i hollësishëm i ndikimit rregullator, duke përfshirë mbi të drejtat e njeriut dhe pajtueshmërinë gjinore, është thelbësor. Ky lloj i vlerësimit të ndikimit duhet të përmbajë një analizë adekuate të problemit, duke përdorur teknika të bazuara në prova për të identifikuar opsionin rregullator më efikas dhe më efektiv.⁴⁶ Në rast se një vlerësim i tillë i ndikimit nuk është kryer ende, **hartuesit e ligjit inkurajohen të bëjnë një rishikim të tillë të hollësishëm, për t'i identifikuar problemet ekzistuese dhe për t'i përshtatur zgjidhjet e propozuara në përputhje me këtë.**
69. Në dritën e asaj që u tha më sipër, **inkurajohen autoritetet publike të sigurojnë se përderisa vazhdon procesi legjislativ, Propozim-ligji t'i nënshtrohet konsultimeve të mëtejshme gjithëpërfshirëse, të gjera dhe efektive me një spektër të gjerë dhe të larmishëm të palëve të interesit nga të gjitha sferat e jetës publike dhe private, duke përfshirë shoqërinë civile (në veçanti organizatat që i promovojnë të drejtat e grave), e gjithashtu edhe me përfaqësues të komuniteteve pakicë dhe të grupeve të pafavorizuara, duke ofruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat me prejardhje të ndryshme që të marrin pjesë. Sipas parimeve të cekura më lart, konsultimet e tilla duhet të zhvillohen në kohën e duhur, në të gjitha fazat e procesit të hartimit të ligjeve, duke përfshirë edhe para Parlamentit. Si një element i rëndësishëm i hartimit të mirë të ligjeve, duhet të vendoset një sistem i qëndrueshëm i monitorimit dhe i vlerësimit të zbatimit të Ligjit dhe ndikimit të tij, i cili do të vlerësonte në mënyrë efikase funksionimin dhe efektivitetin e Propozim-ligjit, pasi të miratohet.**⁴⁷

7.2. Hartimi i ligjeve neutrale ndaj gjinisë

70. Është vërejtur pozitivisht se, në përgjithësi, Propozim-ligji përdor terminologji neutrale gjinore. Megjithatë, disa dispozita ende u referohen individëve që mbajnë pozicione të caktuara zyrtare ose që i përkasin një kategorie të caktuar duke përdorur vetëm formën

⁴³ Raportuesi Special i KB-ve për Lirinë e Fesë ose Besimit, [Raporti i vitit 2018 mbi Misionin në Uzbekistan](#), A/HRC/37/49/Add.2, 22 shkurt 2018, paragrafi 101 (b).

⁴⁴ Shih p.sh. [Rekomandimet për Rritjen e Pjesëmarrjes së Shoqatave në Proceset e Vendimarrjes Publike](#) (nga pjesëmarrësit në Forumin e Shoqërisë Civile të organizuar nga OSBE/ODIHR-i në margjinat e Takimit Plotësues të Dimensionit Njerëzor për Liritë e Tubimit dhe Bashkimit Paqësor të vitit 2015), Vjenë 15-16 prill 2015.

⁴⁵ Shih p.sh. *po aty* shënimi në fund të faqes 90, Seksioni II, Nën-Seksioni G për të Drejtën për të marrë pjesë në punët publike (Udhëzimet e OSBE/ODIHR-it për Mbrojtjen e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut të vitit 2014).

⁴⁶ Shih p.sh., ODIHR, [Vlerësimi paraprak i procesit legjislativ në Republikën e Uzbekistanit](#) (11 dhjetor 2019), Rekomandimet L dhe M; dhe Komisioni i Venedikut, [Lista e kontrollit për sundimin e ligjit](#), CDL-AD(2016)007, Pjesa II.A.5.

⁴⁷ Shih p.sh., OBEZh, [Praktikat ndërkombëtare për vlerësimin e mëvonshëm \(ex post\)](#) (2010).

mashkullore të termit, që le të nënkuptohet se pozicioni plotësohet vetëm nga një burrë. Për më tepër, në disa raste, format mashkullore "ai/tij" përdoren ende në vend të "atij ose asaj"/"e tij ose e saj" (shih nenin 33 të Propozim-ligjit). Praktika e vendosur ndërkombëtare kërkon që legjislacioni të hartohet në një mënyrë neutrale/të ndjeshme ndaj gjinisë.⁴⁸ Rekomandohet që, kurdoherë që është e mundur, e përveç nëse kjo përshtypje është për shkak të përkthimit të gabuar, referenca për mbajtësit e posteve ose për disa kategori individësh të përshtatet për të përdorur një fjalë neutrale gjinore. Përndryshe, forma shumë e emrit përkatës mund të përdoret në vend të njëjësit (p.sh., ata ose e tyre) ose rekomandohet të përdoren të dyja fjalët, edhe mashkullore edhe femërore, për shembull "e tij/e saj" ose "atij/asaj".⁴⁹

REKOMANDIMI H.

Të sigurohen konsultime publike adekuate dhe në përmasa të gjera gjatë hapave të ardhshëm të procesit të hartimit të ligjeve. Të rishikohet Propozim-ligji dhe të sigurohet që në tërë tekstin është përdorur terminologji neutrale gjinore.

[FUNDI I TEKSTIT]

⁴⁸Shih p.sh., ODIHR, [Komente mbi Ligjin për Kuvendin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nga Këndvështrimi Gjinor dhe i Diversitetit](#) (2020), paragrafët 105-107; dhe [Bërja e ligjeve që funksionojnë për gratë dhe burrat: Udhëzues Praktik për Legjislacionin e Ndjeshëm Gjinor](#) (2017), faqja 63. Shih gjithashtu Komisionin Ekonomik dhe Social të KB-ve për Azinë Perëndimore (KESAP), [Gjuha e Ndjeshme Gjinore](#) (2013); Parlamenti Evropian, [Rezoluta për Integrimin Gjinor](#) (2019); Këshilli i Bashkimit Evropian, [Sekretariati i Përgjithshëm, Komunikimi Përfshirës në SPK'](#) (2018); dhe [Paketa e mjetëve për komunikimin e ndjeshëm gjinor](#) (2018) e Institutit Evropian për Barazi Gjinore

⁴⁹Shih p.sh., ODIHR, [Raporti mbi Vlerësimin e Procesit Legjislativ në Republikën e Armenisë](#) (Tetor 2014), paragrafët 47-48.